

VENDIM
Nr. 45, datë 30.4.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET: “ARRAS”, “FUNARES”,
“DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”, “LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”,
“ZERQAN”, “BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”, “BARMASH”,
“LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” DHE “TRESKE 2” TË SHOQËRISË
“BALKAN GREEN ENERGY” SHPK SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “ARRAS”, “FUNARES”, “DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”, “LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”, “ZERQAN”, “BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”, “BARMASH”, “LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” dhe “TRESTE 2” si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për hecet: “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2” si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani